



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytëtarinë Aktive  
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

# Implementimi i Programit Qeveritar 2008-2011

SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosova Foundation for Open Society

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Qëndrimet në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e Ambasadës

### Përmbajtja

|  |    |
|--|----|
| Hyrje  | 3  |
| Përmbledhje e Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008 - 2011 | 4  |
| Arsimi   | 5  |
| Politika e jashtme e Republikës së Kosovës                               | 9  |
| Reforma e administratës publike  | 12 |
| Sundimi i ligjit   | 16 |
| Transporti   | 23 |
| Konkluzione dhe rekomandime  | 26 |
| Falënderime  | 30 |
| Rreth Lëvizjes FOL   | 30 |

### Hyrje

Programi qeveritar paraqet një tërësi gjithëpërfshirëse, të integruar dhe koherente politikash që qeveria e një shteti planifikon t'i implementojë në fusha të ndryshme gjatë mandatit të saj qeverisës. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008 - 2011 është strukturuar në objektiva kryesore, politika prioritare dhe politikat e parapara për t'u implementuar gjatë mandatit në fusha të ndryshme me qëllim të arritjes së objektivave kryesore.

Ky raport ka për qëllim që, duke përdorur të dhëna nga burime të ndryshme, t'i sjellë lexuesit një pasqyrë të qartë dhe krahasuese të politikave të planifikuara në Programin e Qeverisë dhe atyre të implementuara gjatë mandatit të saj në një numër fushash. Periudha kohore të cilën e mbulon ky raport tashmë ka përfunduar.

Duke ditur faktin se ky program përfshin një numër të gjerë politikash dhe mbulon një periudhë relativisht të gjatë kohore, ai fokusohet vetëm në një numër sektorësh, që janë të një interesi më të lartë për publikun e gjerë dhe ndërlidhen më tepër me aktivitetet e Lëvizjes FOL, respektivisht:

- Arsimin (në kuadër të politikës prioritare të rritjes ekonomike);
- Politikën e jashtme të Republikës së Kosovës (në kuadër të politikës prioritare të implementimit të statusit);
- Reformën e administratës publike (në kuadër të politikës prioritare të qeverisjes së mirë);
- Sundimin e ligjit (i vendosur në kuadër të politikës prioritare të rritjes ekonomike);, dhe
- Politikën e transportit (në kuadër të politikës prioritare të rritjes ekonomike).

Sa i përket strukturës së raportit, në fillim jepet një përmbledhje e politikave dhe masave që Qeveria në programin e saj kishte planifikuar t'i implementonte në fushat në të cilat fokusohet ky raport, kurse në pjesën e dytë jepet një vlerësim mbi shkallën e implementimit të masave të parapara, duke përmbledhur si të arriturat ashtu edhe çështjet në të cilat ka pasur mundësi të kishte më tepër arritje. Ky lloj vlerësimi bëhet duke i krahasuar synimet e përcaktuara nga ky program në kuadër të fushave në të cilat fokusohet raporti me të dhëna nga burime të ndryshme, përfshirë ato brenda Qeverisë.

Programi si i tillë prek të gjitha fushat me interes për qytetarët, mirëpo një nga mangësitë kryesore të tij është mosarritja e përfshirjes së masave realisht të arritshme, gjë që më së miri vërehet nga mospërdorimi i indikatorëve për realizimin e tyre. Kjo, në anën tjetër, e bën të vështirë vlerësimin e implementimit të këtij programi, aq më tepër që as dokumentet e tjerë strategjikë të Qeverisë (Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Plani i Veprimit për implementimin e Partneritetit Evropian, Plani Vjetor i Punës i Qeverisë, dhe strategjitë sektoriale) nuk janë zhvilluar në atë masë sa që do të mundësonin një vlerësim adekuat, kryesisht për shkakun se jo të gjithë objektivat strategjikë është arritur të zërthehen në aktivitete të zbatueshme, por gjithashtu nuk janë buxhetuar në mënyrë të saktë e as reflektohen në mënyrë sistematike në kuadër të planeve vjetore të punës së institucioneve përgjegjëse. Për më tepër, nuk ka informata të publikuara nëse ndonjëherë Qeveria apo Kuvendi i Kosovës kanë dalë me ndonjë raport vlerësues rreth këtij Programi, gjë që shton më tej vështirësitë në vlerësimin e implementimit të Programit trevjeçar të Qeverisë.

### Përmbledhje e Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008 - 2011

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008-2011 u miratua në prill 2008, tre muaj pas formimit të Qeverisë, gjë që në atë kohë solli një sërë shqetësimesh nga shoqëria civile, mediet dhe opozita. Kur u miratua, Programi paraqiti si objektivë të përgjithshme integrimin e Kosovës në BE, përmes progresit afat-mesëm që do të arrihej në kuadër të këtyre katër shtyllave prioritare:<sup>1</sup>

- Rritja ekonomike;
- Implementimi i statusit;
- Qeverisja e mirë dhe
- Zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social.

Sa i përket shtyllës së *zhvillimit ekonomik*, Programi Qeveritar kishte paraparë një numër masash që do të sillnin rezultate pozitive në një sërë fushash të ndërlidhura me të, si energjia dhe minierat, transporti, arsimit, bujqësia, sektori financiar etj.. Në kuadër të tyre, transportit dhe arsimit i janë dedikuar pjesa më e madhe e buxhetit për periudhën raportuese, fusha këto ku janë shënuar rezultate pozitive (investime kapitale si shtrimi i rrugëve e ndërtimi i shkollave, pastaj rritja e pagave, etj), por gjithashtu ka pasur efekte kundërtënëse (ndikimi në politikat e shëndosha financiare, koncentrim i aktivitetit, dyshime për korrupsion në këta sektorë, dhe dëmtim të marrëdhënieve kontraktuale me FMN-në).<sup>2</sup>

Sa i përket shtyllës së *implementimit të statusit*, Programi i kishte dhënë prioritet miratimit të kornizës ligjore të paraparë në kuadër të Planit të Ahtisaarit, krijimit të institucioneve të reja (si Ministria e Punëve të Jashtme dhe ajo e Forcës së Sigurisë, tranzicioni nga TMK në FSK), si dhe implementimin e dispozitave të këtij Plani për decentralizimin.<sup>3</sup> Fushat në kuadër të kësaj shtylle janë ato ku është arritur sukses më i madh. Korniza e kërkuar ligjore është miratuar në kohë rekord (me procedurë të përshpejtuar), institucionet përkatëse janë krijuar dhe ka filluar funksionimi i tyre (MFSK dhe FSK janë zhvilluar në kohë të shpejtë dhe tranzicioni nga TMK në FSK është kryer pa shumë vështirësi, edhe pse duket se MPJ ka ngecur mbrapa), si dhe janë krijuar Komunitat e reja në kuadër të një procesi të decentralizimit të vlerësuar lart nga akterët ndërkombëtarë në Kosovë.<sup>4</sup>

Në kuadër të shtyllës së *qeverisjes së mirë*, Qeveria si qëllim primar kishte përcaktuar përmirësimin e performancës së institucioneve qeveritare, në veçanti të atyre që merren me mbledhjen dhe shpenzimin e parasë publike, me një fokus të veçantë në reformimin e administratës publike, përmes përmirësimit të financave publike, luftimit të korrupsionit

---

<sup>1</sup> Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008 – 2011, fq. 6, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi\\_Qeveritar\\_2008\\_-\\_2011.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_Qeveritar_2008_-_2011.pdf)

<sup>2</sup> Ibid, fq. 7

<sup>3</sup> Ibid, fq. 32

<sup>4</sup> Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën 2010, fq. 8,

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2010/package/ks\\_rapport\\_2010\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf); Deklaratë nga GND, 14 qershor 2010, <http://www.ico-kos.org/d/100614%20ISG%20communiqu%20ENG.pdf>. Megjithatë, duhet theksuar se përdorimi i procesit është implementuar suksesshëm, deri më tani krijimi i komunës së re në veriun e Mitrovicës ka dështuar.

dhe përmirësimit të shpenzimeve kapitale.<sup>5</sup> Duhet theksuar se sa i përket reformës së administratës publike, përparimi i arritur është i kufizuar kryesisht në përfundimin e rishikimit funksional dhe horizontal të institucioneve të Qeverisë.

dhe miratimin e legjislacionit kornizë mbi Shërbimin Civil. Megjithatë, përkushtim jo-adekuat i është dhënë qeverisjes elektronike (sidomos në periudhën para ri-formatimit të Qeverisë në prill 2010), përderisa janë shënuar ngecje si në përgatitjen e një strukture për implementimin e legjislacionit të përmendur ashtu edhe për implementimin e rishikimit funksional, e në veçanti të atyre rekomandimeve që i detyrojnë të gjitha strukturat e Qeverisë së Kosovës që të hartojnë e implementojnë plane strategjike zhvillimore, pasi që këto plane janë kusht themelor për një fillim të suksesshëm të reformës së administratës publike.

Ndërsa në kuadër të shtyllës së *zbutjes së varfërisë dhe stabilitetit social*, Qeveria kishte paraparë kryesisht masa për intervenim direkt në fushën e pensioneve dhe shëndetësisë.<sup>6</sup> Kjo është një nga fushat ku intervenimi qeveritar ka qenë më modesti krahasuar me fushat e tjera, për sa i përket prioritizimit.

Në fund, tek *'politikat e tjera qeveritare'* është përfshirë një kombinim mishmash politikash, pa ndonjë ndërlidhje koherente mes tyre, që nga diaspora e deri te fuqizimi i sportit kosovar jashtë vendit.<sup>7</sup>

Ajo çfarë mund të vërehet në këtë program është se edhe pse prek shumë nga fushat me interes për qytetarin, atij i mungonte një qasje koherente dhe prioritete qeveritare të qarta e të arritshme. Kjo vërehet sidomos në fushën e sundimit të ligjit, e cila është përfshirë te shtylla e rritjes ekonomike, dhe në kuadër të së cilës aspektet e respektimit të së drejtës pronësore (të cilat kanë më së shumti rëndësi për rritjen ekonomike) nuk përmenden fare. Ose, vendosja e forcimit të sektorit privat nën kapitullin *e politikave të tjera të Qeverisë*, në fund të programit, e jo në kuadër të shtyllës së rritjes ekonomike.

Në vijim, ky raport shtjellon në mënyrë më të hollësishme masat e parapara në këtë Program, si dhe zhvillimet e ngecjet gjatë periudhës dhe në kuadër të sektorëve që mbulon.

---

<sup>5</sup> Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008 – 2011, fq. 38-39, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi\\_Qeveritar\\_2008\\_-\\_2011.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_Qeveritar_2008_-_2011.pdf)

<sup>6</sup> Është interesant të vërehet se Programi i Qeverisë, nuk përmend askund politikat e punësimit si prioritet për periudhën kohore në fjalë.

<sup>7</sup> Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008 – 2011, fq. 48, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi\\_Qeveritar\\_2008\\_-\\_2011.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_Qeveritar_2008_-_2011.pdf)

### Arsimi

#### Objektivat

Si objektiva strategjike në fushën e arsimit, Programi ka identifikuar pesë prej tyre: a) Sistemi arsimor t'i shërbejë një shoqërie të bazuar në dije, ekonomi dhe punësim; b) Sistemi arsimor të jetë në linjë paralele me nevojat e zhvillimit ekonomik; c) Sistem arsimor gjithëpërfshirës; ç) Avancimi i gjendjes materiale të arsimit, dhe d) Vendosja e mekanizmave për kontrollin e cilësisë.<sup>8</sup>

Për arritjen e këtyre objektivave, Qeveria ka përcaktuar masat si në vijim:

- a) *Krijimin e një sistemi të përbashkët të arsimit dhe të aftësimeve*: përmes kësaj mase do të zhvillohej bashkëveprim ndër-sektorial në hartim politikash, ndarje buxheti dhe implementimin e tyre. Me këtë mëtohet kalimi nga financimi i arsimit në investimin afatgjatë për të.
- b) *Një arsim fillor dhe të mesëm për të gjithë qytetarët*, ku ishin paraparë masa për arritjen e përfshirjes së të gjithë të rinjve në sistemin e arsimit, sidomos duke siguruar shkallë më të lartë të arritshmërisë për ta, rishikimin e plan-programeve mësimore, ndërtimin e hapësirave shtesë shkollore, pajisjen me kompjuterë dhe lidhjen në Internet të të gjitha shkollave, rritjen e pagave të mësimdhënësve dhe masa për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta.
- c) *Sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë*: përmes kësaj mase Qeveria e Kosovës synonte sigurimin e përfshirjes më të madhe të gjeneratës së re në arsimin e lartë, në përputhje me kërkesat e tregut të punës, rritjen e numrit të institucioneve private dhe publike të arsimit të lartë dhe numrit të programeve në këto institucione, rritjen e numrit të të punësuarve nga radhët e të diplomuarve, zvogëlimin e kohëzgjatjes dhe përfundimit të studimeve, vendosjen e strukturave për vlerësim dhe akreditim, ngritjen e infrastrukturës dhe themelimin e instituteve për kërkime shkencore, integrimin e arsimit të lartë në proceset zhvillimore evropiane dhe botërore, mbështetjen e studentëve dhe mësimdhënësve përmes bursave të ndryshme dhe sigurimit të donacioneve për mbështetje arsimit të lartë, rritjen e hapësirës për qëllime akademike dhe rritjen e numrit të bibliotekave bashkëkohore.
- d) *Arsimim profesional dhe mësim gjatë tërë jetës*: gjatë mandatit qeveritar 2008 - 2011 synohej promovimi i mësimit gjatë të jetës, ndër të tjera, përmes ndërtimit të shtatë shkollave profesionale të nivelit të mesëm në qendrat më të mëdha të vendit (për fushat e teknologjisë së informacionit, ekonomisë dhe biznesit, menaxhmentit dhe tregtisë, agrikulturës, shëndetësisë dhe infermierisë, profileve teknike dhe ndërtimtarisë).<sup>9</sup>

---

<sup>8</sup> Ibid, fq. 20.

<sup>9</sup> Ibid, fq. 20-24.

### Implementimi

Gjatë këtyre tre vjetëve që mbulon ky raport, fushës së arsimit në Kosovë i janë ndarë rreth €126 milionë, prej të cilave €99 milionë ishin të destinuara për shpenzime kapitale.<sup>10</sup> Këto investime kryesisht janë bërë me qëllim të përmirësimit të gjendjes përmes ndërtimit të objekteve shkollore, furnizimit me pajisje teknologjike dhe biblioteka, si dhe ndarjes falas të teksteve shkollore për nivelin fillor dhe familjet e varfra.

Programi ambicioz i Qeverisë për përmirësimin e infrastrukturës në arsim, i cili pritej të ndikonte në përmirësimin e gjithëpërfshirës dhe kualitetit të mësimdhënies, përfundoi me ndërtimin e rreth 100 shkollave të reja, gjatë periudhës 2008-2010.<sup>11</sup> Gjithashtu, që nga viti 2008 ka filluar ndarja e teksteve shkollore falas, dhe është hartuar abetarja e re. Me gjithë përpjekjet për krijimin e kushteve për mësim, numri i nxënësve që braktisin shkollën mbetet i lartë. Vetëm gjatë vitit 2010, 5,128 nxënës kanë braktisur shkollat fillore dhe të mesme kosovare.<sup>12</sup>

Me qëllim të ngritjes së cilësisë së arsimit, më 2008 MASHT ka themeluar Komisionin Qendror Shtetëror të Maturës, i cili udhëheq planifikimin dhe realizimin e këtij vlerësimi në nivel vendi. Në të tri vitet provimi i maturës është mbajtur në dy afate (qershor dhe gushtit).<sup>13</sup> Të arriturat në përmirësimin e infrastrukturës dhe përafrimin me standardet e BE-së raportohen edhe në Raportin e Progresit të KE 2009, ku megjithatë theksohet mungesa e kualitetit, e kushteve optimale, si dhe probleme me vijueshmëri e cilësi të dobët të mësimdhënies dhe mësim-nxënies.<sup>14</sup>

Me qëllim të arritjes së një arsimi më kualitativ, Këshilli Shtetëror i Kurrikulit të Kosovës ka hartuar Kornizën e Kurrikulit gjatë vitit 2009, e cila përcakton fushat e reja mësimore dhe njohuritë, aftësitë e shkathtësitë që nevojitet të zotërojnë të gjithë nxënësit në sistemin arsimor të Kosovës.<sup>15</sup>

Me qëllim të vendosjes së meritokracisë, në vitin 2009 është themeluar Këshilli për Licencimin e Mësimdhënësve, dhe në vitin 2010 Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Gjithashtu është funksionalizuar Këshilli për Arsim Profesional dhe Trajnime.<sup>16</sup> Megjithatë, të dy këto institucione përballen me kufizime në kapacitetet dhe funksionalitetin e tyre. Sistemi i pagave lidhet ngushtë me procesin e licencimit dhe kualifikimeve.

---

<sup>10</sup> Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012, fq. 96, <http://mef-rks.org/sr/download/korniza-afatmesme-e-shpenzimeve/2017-korniza-afatmesme-e-shpenzimeve-2010-2012>

<sup>11</sup> Raport i Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës 2009, fq. 42, Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë; dhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2012-2014, fq. 100, <http://mef-rks.org/en/download/korniza-afatmesme-e-shpenzimeve/4025-korniza-afatmesme-e-shpenzimeve-2012-2014>

<sup>12</sup> Gazeta Ekspres (20 shkurt 2011), <http://www.gazetaexpress.com/index.php?cidç1,15,47904>

<sup>13</sup> Raport i të Arriturave të Qeverisë Thaçi 2008-2010, Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë

<sup>14</sup> Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën 2009, fq. 49,

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2009/ks\\_rapport\\_2009\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/ks_rapport_2009_en.pdf)

<sup>15</sup> Ibid, fq. 44

<sup>16</sup> Ibid, fq. 49

Për sa i përket përfshirjes së komuniteteve pakicë në arsim, MASHT ka zhvilluar kurrikulin në gjuhën rome dhe ka krijuar komision të pavarur për rishikimin e plan-programit në gjuhën serbe. Gjithashtu MASHT ka botuar një numër tekstesh në gjuhët e minoriteteve dhe ka ndarë bursa studimi për pjesëtarët e tyre.<sup>17</sup>

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes së fëmijëve me nevoja të veçanta, MASHT që nga 2008 është përqendruar në evidentimin e rasteve përmes komunikimit me prindër, dhe ka caktuar 6 mësimdhënës udhëtues, të cilët në kuadër të qendrave burimore kanë punuar në përmirësimin e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim. Gjatë periudhës 2008-2010 janë identifikuar shumë nxënës me nevoja të veçanta: derisa në vitin shkollor 2008-2009 numri i tyre ka qenë 909, në fund të vitit 2010 ka arritur në 1,179 (një rritje prej 30%).<sup>18</sup> Një arritje e konsiderueshme vlerësohet edhe shndërrimi i tri institucioneve parashkollore dhe tri shkollave të rregullta në institucione gjithëpërfshirëse.

Për sa i përket arsimimit profesional, janë ndërtuar qendra të kompetencës në Skenderaj dhe Malishevë, kurse në proces të ndërtimit janë qendrat në Ferizaj, Gjilan, Prizren dhe Prishtinë.<sup>19</sup>

Në lidhje me arsimin e lartë, në Kosovë tani për tani funksionojnë dy universitete publike, dhjetë kolegje universitare private, pesë shkolla profesionale dhe tre institute.<sup>20</sup> Gjatë këtyre tre viteve në arsimin e lartë kosovar janë investuar rreth €45 milionë, kryesisht në infrastrukturën universitare dhe rritjen e pagave të mësimdhënësve.<sup>21</sup>

Në kontekst të zhvillimit të kapaciteteve për hulumtime është miratuar programi i shkencës në Republikën e Kosovës, ndërsa Këshilli për Hulumtime ka zhvilluar Strategjinë Kombëtare për Shkencë 2010-2015, e cila synon rritjen graduale të investimeve në hulumtim dhe në stimulimin e bashkëpunimit me industrinë, institucionet homologe në BE dhe me partnerë të tjerë ndërkombëtarë. Përveç kësaj, Ministria e Arsimit në vitin 2010 ka ndarë €1 milion për Programin për Avancimin e Shkencës, i cili ka për qëllim avancimin e kërkimeve shkencore në Kosovë.<sup>22</sup> Megjithatë, KE si njëri nga donatorët kryesorë në këtë fushë, kishte vlerësuar se zbatimi i këtyre masave është dëmtuar nga mungesa e fondeve.<sup>23</sup>

Në përgjithësi, gjatë mandatit 2008-2010 shihet se Qeveria ka realizuar një serë aktivitete në fushën e arsimit, gjithashtu duke rritur shkallën e shpenzimeve në këtë

---

<sup>17</sup> Konkluzionet e Nën-Komitetit të DPSA për Drejtësi, Liri dhe Siguri, shkurt 2011, fq. 22,

[http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu\\_kosovo/110413\\_sapd\\_ils\\_subcommittee\\_conclusions\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/110413_sapd_ils_subcommittee_conclusions_en.pdf)

<sup>18</sup> Raport i të Arriturave të Qeverisë Thaçi 2008-2010, Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë

<sup>19</sup> Raporti i Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës 2009, fq. 47, Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë

<sup>20</sup> Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr. 04/134, 14 korrik 2010, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_134-te\\_te\\_Qeverise\\_2010.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_134-te_te_Qeverise_2010.pdf)

<sup>21</sup> Investimet Publike në Sektorin e Arsimit,

[http://levizjafol.org/images/uploads/files/Raporti\\_mbi\\_Investimet\\_Publike\(2\).pdf](http://levizjafol.org/images/uploads/files/Raporti_mbi_Investimet_Publike(2).pdf)

<sup>22</sup> Konkluzionet e Nën-komitetit të DPSA për Inovacion, Kapital Njerëzor, Politika Sociale dhe Shoqëritë Informativë, mars 2010, fq. 6,

[http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu\\_kosovo/100507\\_sapd\\_inno\\_final\\_conclusions\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/100507_sapd_inno_final_conclusions_en.pdf)

<sup>23</sup> Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën 2009, fq. 49,

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2009/ks\\_rapport\\_2009\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/ks_rapport_2009_en.pdf)



fushë. Megjithatë, shoqëria kosovare përballet me probleme strukturore sa i përket arsimimit dhe investimet publike duhet të orientohen në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve njerëzore, në bashkëpunim të ngushtë dhe në një fushëveprim më të gjerë fushash me institucionet e huaja arsimore. Ende nuk janë zhvilluar kapacitete të mjaftueshme për planifikim adekuat strategjik dhe implementim të kornizës strategjike dhe asaj ligjore në këtë fushë. Siç është vlerësuar edhe në raportet e progresit të KE-së, Kosova pothuajse ende nuk ka zhvilluar kapacitete për hulumtime shkencore. Ndër të tjera, kapacitete hulumtuese nuk mund të zhvillohen përderisa nuk zhvillohen dhe implementohen masa të qëndrueshme dhe strategjike për reformimin e sistemit të arsimit të lartë në përgjithësi, e në veçanti nëse nuk i jepet prioritet kontrollit të cilësisë dhe rritjes së investimeve kapitale në ngritjen e kapaciteteve të universiteteve (sidomos atyre publike) për hulumtime shkencore. Përveç këtyre, kjo gjithashtu kërkon avancimin e bashkëpunimit me universitete të vendeve të tjera (në veçanti të atyre që funksionojnë sipas 'sistemit të Bolonjës'), por edhe përmirësim të dukshëm të ndërlidhjes në mes të universiteteve dhe kualifikimeve që ato ofrojnë dhe tregut të punës.

### Politika e Jashtme e Republikës së Kosovës

#### Objektivat

Në aspektin e përgjithshëm të zhvillimit të politikës së jashtme, Programi i Qeverisë përmbante objektivat e përgjithshme të saj me synim përsheptimin e procesit të njohjes, thellimin e marrëdhënieve me SHBA, BE dhe vendet fqinje, zhvillimin e Shërbimit Diplomatik dhe Konsullor, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, sikurse edhe angazhimin për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe afirmimin e identitetit të vendit jashtë.<sup>24</sup>

Programi gjithashtu parashihte një numër masash për arritjen e këtyre synimeve:

- a) Funkcionalizimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme;
- b) Vendosjen e misioneve të Kosovës në organizatat ndërkombëtare;
- c) Zhvillimin e reformave për përafrim me BE-në;
- d) Anëtarësimin në NATO;
- e) Anëtarësimin në OKB, dhe
- f) Nënshkrimin e konventave që ndërlidhen me marrëdhëniet ndërkombëtare, të drejtat e njeriut, mbrojtjen e ambientit, arsim, etj..<sup>25</sup>

#### Implementimi

Gjatë kohës së implementimit të Programit të Qeverisë 2008-11, janë ndarë rreth 53 milionë euro për fushën e politikës së jashtme, nga të cilat rreth 25 milionë për shpenzime kapitale.<sup>26</sup>

Ministria e Punëve të Jashtme u themelua përmes ligjit relevant, në qershor 2008.<sup>27</sup> Pas themelimit të Ministrisë, ajo ka përgatitur Ligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës, të cilët kanë hyrë në fuqi në fillim të vitit 2009, si dhe ka plotësuar kornizën e vet institucionale, sidomos përmes transferimit të stafit nga Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Gjithashtu gjatë vitit 2009 Ministria ka hartuar dy projektligje të reja, Projektligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe Projektligjin për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, si dhe legjislacionin sekondar për rregullimin e punës së Ministrisë dhe funksionimin e Shërbimit Diplomatik dhe Konsullor të Republikës së Kosovës.<sup>28</sup>

---

<sup>24</sup> Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008 – 2011, fq. 36, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi\\_Qeveritar\\_2008\\_-\\_2011.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_Qeveritar_2008_-_2011.pdf)

<sup>25</sup> Ibid, fq. 37.

<sup>26</sup> Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011-2013, fq. 148, <http://mef-rks.org/en/download/korniza-afatmesme-e-shpenzimeve/2769-korniza-afatmesme-e-shpenzimeve-2011-2013>

<sup>27</sup> Për më tepër, shih Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, <http://www.mfa-ks.net/repository/docs/LigjiMinistrinPunDiplomatikKosoves.pdf>

<sup>28</sup> Raporti i Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008, fq. 39, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RAPORTI\\_VJETOR\\_I\\_PUNES\\_SE\\_QEVERISE\\_2008.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RAPORTI_VJETOR_I_PUNES_SE_QEVERISE_2008.pdf)

Gjatë periudhës që mbulon ky raport, Republika e Kosovës ka hapur 20 Ambasada dhe 13 Konsullata të saj në vende të ndryshme të botës.<sup>29</sup> Vështirësia kryesore në funksionalizimin e tyre është stërzgjatja e zhvillimit të kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve konsullore për qytetarët kosovarë, si dhe procesi i rekrutimit të stafit.

Për sa i përket procesit të njohjes së shtetit të ri, gjatë periudhës raportuese Republika e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran është njohur nga 72 shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara, përfshirë shtetet me ndikim si SHBA-të dhe shumicën e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet fqinje e kanë njohur Kosovën, përveç Serbisë.

Pas miratimit të Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së për t'i kërkuar mendim këshillëdhënës Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë rreth asaj se a ishte shpallja e pavarësisë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, kjo e fundit, në korrik 2010 shpalli mendimin se kjo shpallje nuk binte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.<sup>30</sup> Siç duket, të zënë në befasi nga opinioni shumë pozitiv nga ana e GJND-së, Qeveria menjëherë filloi me premtimin e intensifikimit të njohjeve shtesë, edhe pse një gjë e tillë vazhdon të mbetet larg nga ndikimi i saj. Përpjekjet e Serbisë për një rezolutë tjetër në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së përfunduan me propozimin nga ajo të një rezolute, në pajtim me pozicionin e BE-së, që ngërthente në vete fillimin e dialogut teknik në mes të Kosovës dhe Serbisë.<sup>31</sup>

Në kontekstin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, Kosova është bërë anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore në korrik 2009. As që janë zhvilluar përpjekje për anëtarësim në OKB, duke ditur kundërshtimin e sigurt nga disa prej anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit. Pamundësia e anëtarësimit në OKB e bën pothuajse të pamundshme anëtarësimin në organizata të tjera ndërkombëtare. Mosnjohja e Kosovës nga pesë shtete anëtare të BE-së e ka vështirësuar zhvillimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (të cilën e kanë nënshkruar të gjitha shtetet fqinje) në mes të dyjave, edhe pse Komisioni Evropian, që morri një pozicion neutral ndaj statusit, propozoi një lloj që mund të quhet masë kompenzuese për këtë në tetor 2009, në formën e një Marrëveshjeje për Tregti<sup>32</sup>, drejt së cilës, megjithatë, ende nuk është arritur asgjë konkrete, madje as që është bërë publike nga ana e KE-së ndonjë ide me konkrete se çfarë mund të përmbajë dhe kur mund të arrihet.

Normalisht, nënshkrimi i konventave ndërkombëtare është i pamundshëm për aq kohë sa Kosova nuk është anëtare e OKB-së.

Kosova pjesërisht vazhdon pjesëmarrjen në iniciativat rajonale përmes UNMIK-ut, siç është rasti me CEFTA-në, dhe gjatë mandatit të Qeverisë së parë post-pavarësi nuk ka mundur të implementojë ndonjë politikë koherente në lidhje me këtë përfaqësim. Megjithatë, Kosova ka vazhduar të marrë pjesë në iniciativat rajonale, si Këshilli për Bashkëpunim

---

<sup>29</sup> Raporti i Progresit - Made in Kosovo, tetor 2010, fq. 21,

<http://www.gapinstitute.org/repository/docs/RaportiKosovariProgresit.pdf>

<sup>30</sup> Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, *Advisory Opinion of 22 July 2010 - Accordance with international law of the unilateral declaration of independence in respect of Kosovo*, <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/16010.pdf>

<sup>31</sup> Ky dialog ka filluar në kuadër të mandatit të dytë të Qeverisë Thaçi.

<sup>32</sup> *Communication from the Commission to the European Parliament and Council – Kosovo Fulfilling its European Perspective*, 2009, fq. 13, [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2009/kosovo\\_study\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/kosovo_study_en.pdf)

Rajonal (ku edhe paguan kontribut vjetor të anëtarit, prej €40,000), por gjithashtu është pjesëmarrëse edhe në mekanizmat me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit rajonal si Marrëveshja për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA), Traktati i Komunitetit për Energji (ECT), etj.<sup>33</sup>

Në procesin e angazhimeve për zhvillim të marrëdhënieve të mira me fqinjët, demarkacioni ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë ka përfunduar<sup>34</sup>, kurse janë duke u bërë përpjekje për të kryer demarkacionin me Malin e Zi.

Edhe pse ka pasur përparim për sa i përket kapaciteteve të Qeverisë për politikën e jashtme, prapë se prapë kjo fushë përballet me një numër vështirësish, si për nga kapacitetit vendor për të zhvilluar dhe implementuar kornizë të qartë strategjike dhe ligjore, ashtu edhe për të ndërtuar një kornizë institucionale lehtësisht e koordinueshme. Gjithashtu, mosnjohja nga një pjesë e shteteve e vë Qeverinë në pozitë të rëndë për sa i përket zhvillimit të një politike të jashtme cilësore.

---

<sup>33</sup> *Plani i Veprimit për Implementimin e Partneritetit Evropian 2010*, fq. 19, [http://mei-ks.net/repository/docs/PVPE\\_2010\\_Final\\_-\\_SQ.pdf](http://mei-ks.net/repository/docs/PVPE_2010_Final_-_SQ.pdf)

<sup>34</sup> *Inputi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Raportin e Progresit*, shtator 2009, fq. 84, Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë

### Reforma e administratës publike

#### Objektivat

Për sa i përket objektivave rreth reformës së administratës publike, Qeveria në Programin e saj 2008, i kishte grupuar ato në kuadër të reformës së administratës publike dhe qeverisjes elektronike.<sup>35</sup>

Në kuadër të objektivit të parë, që ka të bëjë me reformën në përgjithësi, Programi kishte përcaktuar këto masa: a) rishikimin funksional, b) kompletimin e infrastrukturës ligjore për Shërbimin Civil të Kosovës, c) hartimin e strategjisë për arritjen e objektivave të trajnimit, d) avancimin e sistemit të pagave, e) krijimin e sistemit modern të menaxhimit të personelit, f) përkufizimin e kompetencave thelbësore për kuadrot e larta në Shërbimin Civil të Kosovës. Synim tjetër në këtë fushë Qeveria kishte përcaktuar përmirësimin e infrastrukturës fizike.<sup>36</sup>

#### Implementimi

Gjatë periudhës kohore që mbulon ky raport, fushës së administratës publike i janë ndarë rreth €80 milionë, nga të cilat €50 milionë janë dedikuar për shpenzime kapitale në këtë fushë.<sup>37</sup>

Projekti i reformës së administratës publike kishte filluar qysh në kohën e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes. Në mars 2007 Qeveria kishte miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për zbatimin e Reformës së Administratës Publike.<sup>38</sup> Ajo gjithashtu kishte formuar Komisionin Ndër-ministror për Reformën e Administratës Publike (KNRAP) dhe Grupet Punuese teknike për koordinimin e punës për zbatimin e kësaj Strategjie dhe Plani të Veprimit.<sup>39</sup> KNRAP përbëhet nga një Zëvendëskryeministër, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Ekonomisë dhe Financave (tash Ministri i Financave) dhe Ministri i Shërbimeve Publike (tash Ministri i Administratës Publike). Në kohët e fundit, funksionimi i këtij mekanizmi ka hasur në vështirësi, gjë që mund të vërehet nga fakti që ai është mbledhur vetëm një herë që nga shtatori 2010.<sup>40</sup>

---

<sup>35</sup> Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008-2011, fq. 38, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi\\_Qeveritar\\_2008\\_-\\_2011.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_Qeveritar_2008_-_2011.pdf)

<sup>36</sup> Ibid, fq. 39.

<sup>37</sup> Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011-2013, fq. 155, <http://mef-rks.org/en/download/korniza-afatmesme-e-shpenzimeve/2769-korniza-afatmesme-e-shpenzimeve-2011-2013>. Megjithatë, duhet pasur parasysh se këto mjete i janë ndarë Ministrisë së Administratës Publike, që ka përgjegjësi edhe për menaxhimin e resurseve humane, ndërtimin e ndërtesave qeveritare dhe mirëmbajtjen e tyre, etj. Për shkak të mënyrës së hartimit të buxhetit (ndarja bëhet në kategori si pagat, mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet kapitale) që nuk është i bazuar në rezultate (outcome based) dhe nuk ofron ndërlidhshmëri me politikën qeveritare, është pothuaj e pamundur të vlerësohet se sa mjete ndahen nga Buxheti i Kosovës për një politikë të caktuar, sikurse është Reforma e Administratës Publike.

<sup>38</sup> Për më shumë shih: Strategjia për Reformën Administratës Publike 2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë

<sup>39</sup> Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën 2008, fq. 12, [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press\\_corner/key\\_documents/reports\\_nov\\_2008/kosovo\\_progress\\_report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/key_documents/reports_nov_2008/kosovo_progress_report_en.pdf)

<sup>40</sup> Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën 2011, fq. 14,

[http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu\\_kosovo/20111018\\_progress\\_report\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20111018_progress_report_en.pdf)

*Strategjia për Reformën e Administratës Publike 2007* përmbante tetë objektiva për t'u realizuar në një periudhë kohe prej pesë vjetësh. Objektivat e saj ngërthenin ndërmarrjen e masave për përmirësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore, strukturimin e mekanizmave institucionalë, komunikimin me qytetarë, zhvillimin e mëtejshëm të e-qeverisjes, përmirësimin e sistemit të planifikimit dhe shpenzimit të buxhetit, luftimin e korrupsionit, si dhe përmirësimin e zhvillimit të legjislacionit të përafuar me legjislacionin e BE-së.<sup>41</sup> Në vitin 2010 u vendos për rishikimin saj, kur edhe u vlerësua se kjo Strategji deri në atë kohë ishte implementuar vetëm në masën prej 30%.<sup>42</sup> Strategjia e rishikuar 2010 - 2013 përmban 12 objektiva<sup>43</sup>, që kanë të bëjnë me menaxhimin e politikave, hartimin e legjislacionit, etikën dhe transparencën, komunikimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, planifikimin e buxhetit dhe ekzekutimin tij, auditimin e brendshëm, prokurimin publik, burimet njerëzore dhe e-qeverisjen. Implementimi i kësaj strategjie as që ka filluar, pasi që deri më tani nuk është miratuar Plani i Veprimit për implementimin e saj.<sup>44</sup>

Në të njëjtën kohë, gjatë periudhës që mbulon ky raport u fillua procesi i *rishikimit funksional të administratës publike*, i mbështetur nga projekti Rishikimi Funksional dhe Organizimi Institucional i Ministrive (FRIDOM), financuar nga DfID-i britanik. Në fillim të vitit 2009 ky projekt doli me raportet e rishikimit funksional vertikal (20 institucione, përfshirë të gjitha ministritë) dhe ato të rishikimit horizontal, për 12 fusha.<sup>45</sup> Në fund të procesit të rishikimit, Qeveria është pritur të miratojë këto raporte dhe të fillojë hartimin e planeve strategjike për implementimin e rekomandimeve të rishikimit funksional. Deri më tani janë miratuar planet strategjike zhvillimore për këto institucione: Ministrin e Punëve të Brendshme (MPB), Ministrinë e Administratës Publike (MAP), Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministrinë e Infrastrukturës (MI), Ministrinë e Kthimit dhe të Komuniteteve dhe Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP). Megjithatë, edhe aty ku janë miratuar, implementimi i këtyre planeve mbetet i pamonitoruar sistematikisht edhe sot e kësaj dite nga ana e MAP-it si institucion koordinues i reformës së administratës publike, e cila gjithashtu luan rolin e Sekretariatit të KNRAP-it. Në tetor 2009, MAP ka themeluar Departamentin për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike, me qëllimin kryesor për të koordinuar procesin e planifikimit dhe monitorimit të implementimit të kësaj strategjie. Megjithatë, kapacitetet e këtij departamenti akoma mbeten të dobëta.<sup>46</sup>

Gjithashtu në vitin 2010 janë miratuar dy ligjet kornizë të shërbimit civil: Ligji për Shërbimin Civil dhe ai për Pagat e Shërbyesve Civilë. Vlerësuar si shumë të rëndësishëm në

---

<sup>41</sup> *Strategjia për Reformën e Administratës Publike 2007*, fq. 13, Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë

<sup>42</sup> *Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën 2010*, fq. 9,

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2010/package/ks\\_rapport\\_2010\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf)

<sup>43</sup> Është interesante të vërehet se përderisa Strategjia për RAP 2007 përmbante 8 objektiva për t'u realizuar në një periudhë kohore prej 6 vjetësh, strategjia e re përmban 12 objektiva për t'u përmbushur për një periudhë prej 4 vjetësh, gjë që dëmton shumë realizueshmërinë e masave që ajo përmban.

<sup>44</sup> *Strategjia për Reformën e Administratës Publike 2010-2013*, fq. 6-7, [http://map.rks-gov.net/userfiles/file/Strategjia%20dhe%20Planet/Strategjia\\_e\\_reformes\\_se\\_administrates\\_publike.pdf](http://map.rks-gov.net/userfiles/file/Strategjia%20dhe%20Planet/Strategjia_e_reformes_se_administrates_publike.pdf)

<sup>45</sup> Për më shumë, shihni *Rishikimi Funksional dhe Organizimi Institucional i Ministrive*, <http://map.rks-gov.net/sg/page.aspx?id=73>

<sup>46</sup> *Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën 2010*, fq. 9,

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2010/package/ks\\_rapport\\_2010\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf)

zhvillimin e një shërbimi civil efikas dhe të pavarur, janë hasur shumë vështirësi në implementimin e tyre, duke filluar së pari me vonesën prej më shumë se një viti në miratimin e legjislacionit sekondar.<sup>47</sup>

Gjithashtu janë hasur vështirësi të mëdha në ofrimin e trajnimit për administratën publike, përderisa nuk duket të ketë pasur vullnet politik në forcimin e Institutit Kosovar për Administratë Publike, i cili është përballur me mungesë buxheti të mjaftueshëm, dhe së fundi edhe me probleme të hapësirës fizike për funksionim.<sup>48</sup>

Edhe pse implementimi i një reforme të mirëfilltë të administratës publike duket të ketë mbetur shumë mbrapa, Qeveria i ka kushtuar rëndësi zhvillimit të *qeverisjes elektronike*. Kështu, më 2009 është miratuar Strategjia e Qeverisjes Elektronike 2009 - 2015 dhe Plani e Veprimit për zbatimin e saj.<sup>49</sup> Kjo strategji mëton procesin e shndërrimit të qeverisjes tradicionale në qeverisje elektronike, përkundër faktit se qeverisja 'tradicionale' vlerësohet të ketë mbetur në një stad shumë të hershëm të zhvillimit të saj. Sa u përket përparimeve konkrete në qeverisjen elektronike, është siguruar lidhja e të gjitha komunave dhe institucioneve të tjera (përfshirë edhe ambasadat e vendit) në rrjetin qeveritar. Gjithashtu janë ndërlidhur me rrjet shumica e Zyrave Komunale të Gjendjes Civile, si dhe po realizohet projekti "Qendra e të Dhënave" e Republikës së Kosovës, e cila do të shërbejë për vendosjen e të dhënave të të gjitha institucioneve shtetërore.<sup>50</sup>

Ndërsa, sa u përket sistemeve dhe shërbimeve elektronike, është ndërtuar e-Portali shtetëror, në disa faza, ku vlen të theksohet verifikimi online i dokumenteve të prodhuara për pasaportë, letërnjoftim dhe patentë shoferi, aplikacioni për regjistrim dhe licencim online të bizneseve në kuadër të synimit për e-biznese, moduli për pengun, pastaj sistemi për aplikim online për patentë shoferi. Me gjithë disa elemente pozitive që përmban ky sistem, prapëseprapë përpjekjet e Qeverisë do të duhej të fokusoheshin në reformimin e mirëfilltë të administratës, duke filluar nga ngritja e kapaciteteve për planifikim strategjik, monitorim dhe vlerësim të implementimit të politikave, hartim të legjislacionit si dhe fuqizimin e shërbimit civil, përmes sigurimit të pavarësisë së tij dhe zhvillimit të resurseve humane.<sup>51</sup>

Duke pasur parasysh një numër vështirësish për sa i përket *planifikimit strategjik*, në vitin 2010 u themelua dhe u funksionalizua Zyra për Planifikim Strategjik. Kjo Zyrë si përgjegjësi kryesore do të ketë zhvillimin e një sistemi të integruar politikash në nivel kombëtar dhe, së bashku me institucionet tjera relevante, të sigurojë ndërlidhje buxhetore për implementimin e tyre.<sup>52</sup> Megjithatë, realizimi i objektivave të tilla do të jetë i vështirë duke pasur parasysh mungesën e kapaciteteve të Ministrive për planifikim strategjik.

---

<sup>47</sup> Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën 2011, fq. 9,

[http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu\\_kosovo/20111018\\_progress\\_report\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20111018_progress_report_en.pdf)

<sup>48</sup> Ibid, fq. 9.

<sup>49</sup> Për më shumë, shihni *Strategjia për Qeverisjen Elektronike 2009-2015*, [http://map.rks.gov.net/userfiles/file/Strategjia%20dhe%20Planet/STRATEGJIA\\_E\\_QEVERISJES\\_ELEKTRONIKE\\_2009\\_2015.pdf](http://map.rks.gov.net/userfiles/file/Strategjia%20dhe%20Planet/STRATEGJIA_E_QEVERISJES_ELEKTRONIKE_2009_2015.pdf)

<sup>50</sup> Plani i Veprimit për Implementimin e Partneritetit Evropian 2010, fq. 63, [http://mei-](http://mei-ks.net/repository/docs/PVPE_2010_Final_-_SQ.pdf)

[ks.net/repository/docs/PVPE\\_2010\\_Final\\_-\\_SQ.pdf](http://mei-ks.net/repository/docs/PVPE_2010_Final_-_SQ.pdf)

<sup>51</sup> Ibid, fq. 64.

<sup>52</sup> *Inputi i Qeverisë së Kosovës për Raportin e Progresit*, qershor 2010, fq. 13, Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Në përgjithësi, Qeveria ka ngelur mbrapa në implementimin e reformës së administratës publike ashtu siç ishte paraparë në Programin e saj 2008-2011, sidomos për sa i përket implementimit të Strategjisë për RAP, implementimit të rekomandimeve të dala nga rishikimi funksional, fuqizimit të institucioneve që merren me koordinimin e reformës, si dhe sa i përket fuqizimit dhe sigurimit të pavarësisë së Shërbimit Civil. Shumë më tepër vullnet politik dhe resurse financiare do të duhen për zhvillimin e një reforme të qëndrueshme të administratës publike.



### Sundimi i ligjit

#### Objektivat

Programi definoi si objektiva të përgjithshme të Qeverisë për fushën e sundimit të ligjit kompletimin e kornizës ligjore, sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit, zhvillimin e kapaciteteve të Shërbimit Korrektues dhe atij Sprovues, mbrojtjen e viktimave të krimit dhe të dëshmitarëve, si dhe bashkëpunim ndër-institucional për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në kuadër të planifikimit të Qeverisë në këtë Program janë përfshirë edhe masa për sigurimin e rendit dhe ligjit, përfshirë ngritjen e kapaciteteve të Policisë, formimin e një Këshilli për Sundimin e Ligjit, përmirësimin e dokumenteve civile si dhe menaxhimin e situatave emergjente.<sup>53</sup>

Ajo se çfarë është jo-adekuate për sa i përket trajtimit të kësaj fushe nga ky Program është se së pari ai gjendet vetëm si një nga prioritetet e Qeverisë, dhe atë në kuadër të shtyllës së rritjes ekonomike.<sup>54</sup> Fusha e sundimit të ligjit e përfshirë në këtë Program është njëra nga fushat me më së shumti deficit për sa i përket koherencës së masave të parapara. Zhvillimet në terren gjatë kësaj periudhe janë indikator më adekuat për këtë mungesë koherence.

#### Implementimi

Gjatë periudhës kohore që mbulon ky raport, institucioneve të fushës së sundimit të ligjit u janë alokuar rreth €384 milionë nga buxheti i Kosovës, nga të cilat rreth €105 milionë kanë pasur për destinim projektet kapitale.<sup>55</sup>

Për sa i përket *gjyqësorit*, korniza ligjore për rregullimin e kësaj fushe ishte shumë e mangët në fillimin e implementimit të këtij Programi. Kështu, në atë kohë, gjykatat, prokuroritë dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës po funksiononin bazuar në legjislacionin e UNMIK-ut, kohë kjo kur është vendosur për miratimin e ligjeve përkatëse dhe themelimin e Këshillit Prokurorial. Ky legjislacion është miratuar gjatë vitit 2010, kur edhe është lansuar reformimi i gjyqësorit në Kosovë, përderisa implementimi i tij ka filluar pjesërisht po në të njëjtin vit, kurse implementimi i pjesës tjetër të legjislacionit që ka të bëjë me ristrukturimin e gjykatave dhe prokurorive pritet të fillojë në vitin 2013.<sup>56</sup>

Tjetër zhvillim i rëndësishëm gjatë periudhës që mbulon Programi është edhe procesi i rimërimin të gjyqtarëve dhe prokurorëve, proces ky i menaxhuar nga KGJK, dhe i mbështetur nga USAID dhe Komisioni Evropian përmes një mekanizmi të veçantë për këtë

---

<sup>53</sup> Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008 – 2011, fq. 25-27, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi\\_Qeveritar\\_2008\\_-\\_2011.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_Qeveritar_2008_-_2011.pdf)

<sup>54</sup> Programi i tanishëm i Qeverisë vë sundimin e ligjit si një nga prioritetet kyçe të Qeverisë, sikurse bën edhe Studimi për Kosovën nga Komisioni Evropian.

<sup>55</sup> Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011-2013, fq. 106-127. <http://mef-rks.org/en/download/korniza-afatmesme-e-shpenzimeve/2769-korniza-afatmesme-e-shpenzimeve-2011-2013>

<sup>56</sup> Për më tepër, shihni: *Ligji mbi Gjykatat* (<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-199-alb.pdf>), *Ligji mbi Prokurorin e Shtetit* (<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-225-alb.pdf>), *Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës* (<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-223-alb.pdf>) dhe *Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës* (<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-224-alb.pdf>), miratuar në shtator 2010.

qëllim: Këshillit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGjP). I kritikuar të ketë qenë i ndikuar politikisht, ky proces kishte për qëllim emërimin dhe ri-emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjykatat dhe prokuroritë e të gjitha niveleve, dhe përfshinte verifikimin dhe testimin e kandidatëve për këto pozita. Procesi u krye në tri faza, gjatë vitit 2009 dhe 2010, në fund të të cilit u emëruan/ri-emëruan 334 gjyqtarë dhe prokurorë.<sup>57</sup> Për shkak të pamjaftueshmërisë së kandidatëve të përshtatshëm, në fund të procesit të ri-emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve mbetën edhe 120 pozita vakante, dhe përgjegjësia për plotësimin e tyre i ka kaluar KGJK-së dhe KPK-së.<sup>58</sup> Përparësia e zhvillimit të këtij procesi ishte mundësia e emërimit të një numri të kandidatëve të rinj në gjyqësor si dhe mundësia për eliminimin e disa prej defekteve që kishin bërë që gjyqësori të konsiderohej si njëra nga fushat më të pazhvilluara në vend. Mirëpo, duke pasur parasysh mungesën e zhvillimit institucional të KGJK-së për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit, procesi i ri-emërimit u përmbyll me ndërhyrje serioze politike.<sup>59</sup>

Për më tepër, për sa i takon gjyqësorit, një nga problemet më të mëdha në këtë fushë ka qenë dhe mbetet numri i grumbulluar i rasteve të pazgjdhura sillej diku rreth 200 mijë, numër ky i cili ende e përcjell këtë fushë.<sup>60</sup> Për të adresuar këtë problem ishte paraparë edhe funksionalizimi i një sistemi të ndërmjetësimit si dhe atij të ekzekutimit të rasteve, mirëpo edhe zhvillimi i një sistemi të noterisë, që në mënyra të ndryshme do të tërhiqnin barrën nga gjykatat në punën e tyre.<sup>61</sup> Duhet theksuar se rezultatet në këtë drejtim janë vërejtur vetëm së fundmi me miratimin e Strategjisë për Reduktimin e Lëndëve të Pazgjdhura, themelimit të disa qendrave të ndërmjetësimit dhe licencimin e ndërmjetësve nga Ministria e Drejtësisë, si dhe me themelimin e Zyrës për Ekzekutimin e Lëndëve në kuadër të KGJK-së dhe rekrutimin e rreth 30 zyrtarëve ekzekutues.<sup>62</sup> Gjithashtu fillimi i zhvillimit të sistemit të noterisë përmes licencimit të rreth 84 zyrtarëve pritet të ketë ndikim në këtë fushë.<sup>63</sup> Megjithëse vlerësohet se numri i lëndëve të pazgjdhura është reduktuar për diku rreth 25% gjatë vitit të kaluar, kjo çështje mbetet një nga sfidat më serioze të sistemit gjyqësor në Kosovë.<sup>64</sup>

---

<sup>57</sup> Raport mbi punën e KPGjP-së, tetor 2010, fq. 2, [http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/ALB.Version\\_of\\_the\\_Final\\_Report.pdf](http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/ALB.Version_of_the_Final_Report.pdf)

<sup>58</sup> Konkluzionet e Nën-Komitetit të DPSA për Drejtësi, Liri dhe Siguri, shkurt 2011, fq. 12, [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu\\_kosovo/110413\\_sapd\\_jls\\_subcommittee\\_conclusions\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/110413_sapd_jls_subcommittee_conclusions_en.pdf)

<sup>59</sup> Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën 2010, fq. 10, [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2010/package/ks\\_rapport\\_2010\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf)

<sup>60</sup> Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën 2011, fq. 11, [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu\\_kosovo/20111018\\_progress\\_report\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20111018_progress_report_en.pdf)

<sup>61</sup> Plani i Veprimit për Implementimin e Partneritetit Evropian 2010, fq. 133, [http://mei-ks.net/repository/docs/PVPE\\_2010\\_Final\\_-\\_SQ.pdf](http://mei-ks.net/repository/docs/PVPE_2010_Final_-_SQ.pdf)

<sup>62</sup> Inputi i Qeverisë së Kosovës për Raportin e Progresit, shtator 2011, fq. 11, [http://mei-ks.net/repository/docs/Input\\_to\\_EC\\_Progres\\_Report,\\_September\\_2011.pdf](http://mei-ks.net/repository/docs/Input_to_EC_Progres_Report,_September_2011.pdf)

<sup>63</sup> Ibid.

<sup>64</sup> Një përqindje e tillë mund të jetë rezultat i efektit negativ imediat që duket të ketë pasur procesi i emërimit/ri-emërimit në punën e gjykatave, ku gjyqtarët që nuk kanë kaluar fazat më të hershme të procesit, duke ditur se nuk do të ri-emërohen, kanë zgjidhur lëndë pa respektuar të gjitha procedurat ligjore, gjë që edhe ka rritur në mënyrë artificiale numrin e lëndëve të zgjidhura, sidomos gjatë kohës së zhvillimit të procesit të ri-emërimit. Për më tepër, shihni *Reappointment Process, Independence and Influences*, Forumi për Iniciativa Qytetare dhe Insituti Juridik i Kosovës, gusht 2011, <http://www.fiq-fci.org/?cid=2,2,220>

Për sa i përket *luftimit të korrupsionit*, edhe në këtë fushë korniza ligjore në kohën e fillimit të implementimit të Programit Qeveritar 2008 - 2011 ishte e mangët, duke përfshirë legjislacionin që rregullon parandalimin dhe luftimin e konfliktit të interesit si dhe atë për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. Strategjia për luftimin e korrupsionit ishte miratuar vetëm në fund të vitit 2009, dhe implementimi i saj duket të ketë hasur në vështirësi serioze. Megjithatë, gjatë kohës që mbulon ky Program qeveritar korniza ligjore është përmirësuar, përfshirë iniciimin e punës në drejtim të rishikimit të legjislacionit për prokurim publik, për mbrojtjen e informatorëve, për financimin e partive politike dhe atij rreth përgjegjësisë penale të personave juridikë.<sup>65</sup>

Për sa i takon kornizës institucionale për luftimin e korrupsionit, gjatë kohës në fjalë u funksionalizua Agjencia Kundër Korrupsionit, si dhe *Task Forca* për Luftimin e Korrupsionit, sikurse edhe Drejtoria e Policisë kundër Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike.<sup>66</sup> Gjatë periudhës në fjalë, Agjencisë për Luftimin e Korrupsionit i janë raportuar rreth 460 raste të korrupsionit, dhe pas hetimeve të zhvilluara nga Agjencia, në prokurori janë dërguar 149 raste.<sup>67</sup> Qeveria, gjyqësori dhe ndërmarrjet publike janë institucionet për të cilat është raportuar numri më i madh i rasteve të dyshuara për afëra korruptive.<sup>68</sup>

Gjatë kësaj periudhe, AKK ka zhvilluar ciklet vjetore të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë dhe publikimin e tyre, mirëpo nevojitet zhvillim i mëtejshëm i kapaciteteve të AKK-së për të zhvilluar procesin në mënyrë adekuate, sikurse edhe për të rritur shkallën e zhvillimit të aktiviteteve të vetëdijesimit si rezultat i këtyre deklarimeve.<sup>69</sup> Ajo në çfarë AKK ka hasur më shumë probleme është luftimi i konfliktit të interesit.<sup>70</sup>

Me gjithë përmirësimin në kompletimin e kornizës ligjore dhe asaj strategjike në këtë fushë, korrupsioni konsiderohet të jetë i përhapur gjithandej administratës shtetërore, përfshirë nivelet më të larta politike.<sup>71</sup> Përveç kësaj, kapacitetet e gjyqësorit për të luftuar këtë dukuri kanë mbetur shumë të kufizuara, kurse Qeveria ka dështuar për sa i përket rregullimit të legjislacionit për prokurim publik, gjë që ka çuar në rritjen e numrit

---

<sup>65</sup> Shumica e këtij legjislacioni është miratuar në vitet 2010-2011. Shih Raportet e Progresit të KE-së për Kosovën të viteve përkatëse.

<sup>66</sup> *Task Forca* për Luftimin e Korrupsionit ishte krijuar me vendim të Qeverisë, ku do të merrnin pjesë Prokuroria Speciale, dhe Departamenti i Policisë kundër Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike. Për më shumë, shihni *Inputi i Qeverisë për Raport të Progresit*, qershor 2010, Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë; dhe *Konkluzionet e Nën-komitetit të DLS të DPSA-së*, janar 2010, [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu\\_kosovo/100329\\_sapd\\_jls\\_subcommittee\\_final\\_conclusions\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/100329_sapd_jls_subcommittee_final_conclusions_en.pdf)

<sup>67</sup> *Raportet e Punës së AKK-së* për 2008, 2009, 2010, <http://www.akk-ks.org/?cid=1,16>. Për të dhëna më të hollësishme rreth monitorimit të luftimit të korrupsionit shih raportet e rregullta *Monitoruesi i Korrupsionit*, të publikuara nga Lëvizja FOL që nga janari 2010, [http://levizjafol.org/al/PROJEKTET/monitoruesi\\_i\\_korrupsionit](http://levizjafol.org/al/PROJEKTET/monitoruesi_i_korrupsionit)

<sup>68</sup> Ibid, 30% e rasteve të raportuara janë për Qeverinë, 23% për gjyqësorin dhe 26% për Ndërmarrjet Publike.

<sup>69</sup> Raporti i Progresit Made in Kosova 2011, fq. 29, [http://www.fes-prishtina.org/wb/media/Publications/2011/Made%20in%20Kosovo%202011%20\(Shqip\).pdf](http://www.fes-prishtina.org/wb/media/Publications/2011/Made%20in%20Kosovo%202011%20(Shqip).pdf)

<sup>70</sup> Ibid.

<sup>71</sup> *Raportet e Progresit të KE-së për Kosovën: 2008, 2009, 2010*, nën fushën e Demokracisë dhe Sundimit të Ligjit, Politikat kundër korrupsionit. Gjithashtu, i njëjti vlerësim vjen edhe nga *Raporti i Global Integrity*, *Raporti Amerikan mbi Politikën e Jashtme Amerikane*, *Raporti i FreedomHouse* dhe Raportet e publikuara nga organizatat e ndryshme jo-qeveritare (FOL, ÇOHU dhe Iniciativa Kosovare për Stabilitet).

të kontratave një-burimore.<sup>72</sup> As EULEX nuk duket të ketë demonstruar performancë të kënaqshme në mbështetjen e institucioneve të vendit në luftimin e korrupsionit, përderisa Policia e Kosovës, përkundër përkushtimit në këtë drejtim, nuk ka arritur ende të fuqizojë rolin e vet në kuadër të hetimit të veprave korruptive.<sup>73</sup>

Në anën tjetër, sa i takon *punëve të brendshme*, në fillim të implementimit të Programit Qeveritar 2008-2011, Qeveria u koncentrua në dy prioritetet: mbulimin e fushës me legjislacion vendor, ndër të tjera, edhe si rezultat i shpalljes së pavarësisë së vendit, si dhe mbulimin e saj me kornizë strategjike.<sup>74</sup> Kështu, gjatë periudhës 2008-2009, është miratuar legjislacion që mbulon fushat e dokumenteve personale, të huajve, armëmbajtjes, menaxhimit të integruar të kufijve, policisë dhe azilit.<sup>75</sup> Në anën tjetër, po gjatë të njëjtës periudhë, Ministria e Punëve të Brendshme është angazhuar në mbulimin me kornizë strategjike të fushave që ndërlidhen me punët e brendshme, dhe ka hartuar strategji për një sërë fushash si: luftimi i krimit të organizuar, luftimi i trafikimit me narkotikë, luftimi i trafikimit me qenie njerëzore, menaxhimi i integruar i kufijve, mbledhja e armëve, reduktimi i krimit, luftimi i krimit kompjuterik, etj.<sup>76</sup> Pas miratimit të këtyre strategjive, fusha e punëve të brendshme rezultoi të jetë një nga fushat më të mbuluara strategjiksht. Për të siguruar monitorimin e implementimit të tyre, MPB themeloi pozitën e një koordinatori për monitorimin e tyre dhe një sekretariat për mbështetjen e tij.<sup>77</sup> Për shkak të kapacitetit të kufizuar në planifikim strategjik, monitorimi i implementimit të tyre ka mbetur problematik edhe sot e kësaj dite.

Zhvillimi i kësaj kornize strategjike caktoi si prioritet luftimin e krimit të organizuar (në kuadër të të cilit rëndësi të posaçme i është kushtuar luftimit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe trafikimit me narkotikë, si dhe krimeve ekonomike), menaxhimit të kufijve, zhvillimit të kapaciteteve të Policisë dhe procesit të përmbushjes së kriterëve për liberalizimin e vizave.

Për sa i takon *luftimit të krimit të organizuar*, siç u përmend edhe më lartë, gjatë kësaj periudhe janë disa strategji: Strategjia për Luftimin e Krimit të Organizuar (strategji ombrellë në këtë fushë), Strategjia për Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore, Strategjia për Luftimin e Trafikimit me Narkotikë, dhe Strategjia për Polici të Bazuar në Inteligjencë.<sup>78</sup> Këto strategji, secila në fushën e vet, mëtojnë të rrisin kapacitete e agjencive për zbatimin e ligjit dhe rritjen e bashkëpunimit në mes tyre për luftimin e këtyre lloj krimeve serioze. Megjithatë, luftimi i trafikimit me narkotikë dhe trafikimit të

---

<sup>72</sup> *Raportet e Progresit Made in Kosova 2010 dhe 2011*, seksioni për luftën kundër korrupsionit, <http://www.gapinstitute.org/repository/docs/RaportiKosovariProgresit.pdf>, [http://www.fes-prishtina.org/wb/media/Publications/2011/Made%20in%20Kosovo%202011%20\(Shqip\).pdf](http://www.fes-prishtina.org/wb/media/Publications/2011/Made%20in%20Kosovo%202011%20(Shqip).pdf)

<sup>73</sup> Ibid

<sup>74</sup> Fusha e punëve të brendshme ishte një nga fushat që kërkonte një pjesë të konsiderueshme të legjislacionit të ri bazuar në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit.

<sup>75</sup> *Raporti i Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës 2009*, fq. 51, Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë

<sup>76</sup> *Konkluzionet e Takimit Sektorial të Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim-Asociimit*, maj 2009, fq. 16-17, Qeveria e Republikës së Kosovës, Prishtinë

<sup>77</sup> Ibid.

<sup>78</sup> Strategjia për Policim të bazuar në Inteligjencë është zhvilluar si pasojë e rekomandimeve të EULEX dhe KE në vitin 2008, Për më shumë shih: *Raporti Programatik i EULEX 2009*, <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/Accountability/EULEX-PROGRAMME-REPORT-July-2009-new.pdf>

genieve njerëzore vlerësohet të jetë në një fazë shumë të hershme të zhvillimit, pasi që deri më tani ka dhënë rezultate sporadike dhe të mangëta.<sup>79</sup> Për më tepër, luftimi i këtyre lloj krimesh vazhdon të hasë në shumë vështirësi edhe për arsye të mos-reagimit adekuat nga prokuroritë dhe gjykatat, për shkak të mungesës së kapaciteteve për t'i hetuar dhe gjykuar ato me efektivitet, apo edhe kushteve të nevojshme për prokurorë dhe gjyqtarë.<sup>80</sup> Gjithashtu, bashkëpunimi në mes të agjencive për zbatimin e ligjit dhe gjyqësorit në luftimin e krimit të organizuar mbetet në një nivel shqetësues, siç mund të vërehet edhe nga jo-përputhshmëria e të dhënave që mund të ofrohen nga këto institucione për luftimin e krimit të organizuar.<sup>81</sup>

Për ta bërë situatën edhe më të rënduar, ende nuk është zhvilluar një sistem i qëndrueshëm për mbrojtjen e dëshmitarëve, ndonëse ligji përkatës është miratuar dhe është themeluar Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në kuadër të Policisë së Kosovës.<sup>82</sup> Për më tepër, luftimi i shpëlarjes së parave mbetet problematik për shkak të vështirësive në implementimin e legjislacionit përkatës që kërkon transferimin e kompetencave në këtë fushë nga EULEX-i në Njësinë e Inteligjencës Financiare në kuadër të Ministrisë së Financave. Situata në këtë fushë duket të ketë mbetur e vështirë edhe pas miratimit të Ligjit kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (në shtator 2010) dhe themelimit të Drejtorisë kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në kuadër të PK-së.<sup>83</sup> Në anën tjetër, legjislacioni për konfiskimin e pasurisë së përfituar përmes krimit të organizuar ende nuk është kompletuar, përkundër faktit se Ligji për Menaxhimin e Pasurisë së Konfiskuar është miratuar dhe Agjencia relevante është themeluar gjatë viteve 2009-2010.

Në anën tjetër, për sa i takon menaxhimin të kufijve, në vitin 2009 është miratuar Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufijve 2009 - 2012, që si objektiva kryesore ka vënë rritjen e bashkëpunimit në mes të Policisë, Doganës dhe shërbimeve fito-sanitare kufitare të Agjencisë së Veterinës dhe Ushqimit, si dhe bashkëpunimit në mes tyre dhe institucioneve homologe të vendeve fqinje dhe më gjerë.<sup>84</sup> Për më tepër, gjatë periudhës kohore që mbulon ky raport është punuar në ngritjen e kapaciteteve të Policisë Kufitare, edhe përmes transferimit të një numri zyrtarësh policorë nga pjesët e tjera të PK-së.<sup>85</sup> Gjithashtu, gjatë kohës në fjalë kontrolli i kufirit me Shqipërinë dhe Maqedoninë kaloi nga KFOR tek PK, si dhe janë nënshkruar marrëveshje me këto dy vende për zhvillimin e

---

<sup>79</sup> Shih *Raportet e Progresit të KE-së për Kosovën: 2008, 2009, 2010*, nën fushën e Drejtësisë, Lirisë, Sigurisë – Nën-fusha për Narkotikët dhe për luftën kundër krimit të organizuar.

<sup>80</sup> Referojuni fusnotës 70 më sipër.

<sup>81</sup> *Sundimi i Ligjit në Kosovën e Pavarur*, Grupi Ndërkombëtar i Krizave, maj 2010, fq. 4,

[http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/balkans/kosovo/204%20The%20rule%20of%20Law%20in%20Independent%20Kosovo.pdf](http://www.crisisgroup.org/~/media/Files/europe/balkans/kosovo/204%20The%20rule%20of%20Law%20in%20Independent%20Kosovo.pdf)

<sup>82</sup> *Inputi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Raportin e Progresit*, shtator 2011, fq. 10, [http://mei-ks.net/repository/docs/Input\\_to\\_EC\\_Progres\\_Report\\_September\\_2011.pdf](http://mei-ks.net/repository/docs/Input_to_EC_Progres_Report_September_2011.pdf). Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve do të hyjë në fuqi vetëm në vitin 2012, dhe deri më tani nuk janë vërejtur përgatitje nga ana e Qeverisë dhe Zyrës së Kryeprokurorit në drejtim të fillimit të implementimit të tij pas hyrjes në fuqi të Ligjit (Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve).

<sup>83</sup> *Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën 2010*, fq. 52,

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2010/package/ks\\_rapport\\_2010\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf)

<sup>84</sup> Për më shumë shihni *Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Kufijve*, <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategjia%20Shqip.pdf>

<sup>85</sup> *Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën 2010*, fq. 50,

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2010/package/ks\\_rapport\\_2010\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf)

operacioneve të përbashkëta për luftimin e krimit ndër-kufitar.<sup>86</sup> Vështirësi janë hasur në zhvillimin e kapaciteteve të TI-së për menaxhimin dhe kontrollin e kufijve, ndonëse instalimi i Sistemit për Menaxhimin e Kufirit (*Border Management System - BMS*) duket të ketë bërë të mundshëm tejkalimin e këtyre vështirësive.<sup>87</sup>

Në lidhje me zhvillimin e kapaciteteve të Policisë së Kosovës, për sa i takon zhvillimit institucional, gjatë periudhës që mbulon ky raport është miratuar Ligji për Policinë dhe Plani Strategjik Zhvillimor i Policisë së Kosovës 2008-2010, i cili pastaj është rishikuar në vitin 2010.<sup>88</sup> Gjithashtu, në proces e sipër janë përmirësuar linjat e komandimit në mes të nivelit qendror dhe atij rajonal. Një nga mangësitë kryesore të PK-së, mungesa e operimit të policisë të bazuar në inteligjencë, është duke u adresuar me fillimin e implementimit të strategjisë përkatëse.<sup>89</sup> Për më tepër, gjatë gjithë kësaj kohe, policia ia ka dalë të mbajë rendin dhe qetësinë, edhe pse ajo ende mbetet në fazën të hershme të luftimit në mënyrë efektive të veprave komplekse kriminale si krimi i organizuar dhe korrupsioni.<sup>90</sup> Vështirësitë me të cilat përballet Policia e Kosovës më së miri janë parë me rastin e vjedhjes së një sasive narkotikësh të konfiskuar nga hapësirat e saj dhe hyrjes në grevë të një numri zyrtarësh policorë për rritje rrogash në vitin 2009.

Përveç fushave të mësipërme, në fushën e sundimit të ligjit, gjatë kohës sa ishte i vlefshëm Programi Qeveritar 2008-2011, në mënyrë të njëanshme u fillua edhe zhvillimi i aktiviteteve për fillimin e procesit të liberalizimit të vizave, fillimisht përmes miratimit të një udhërrëfyese dhe plani trevjeçar veprimi për këtë dhe përmes themelimit të një grupi punues për menaxhimin e procesit.<sup>91</sup> Në vjeshtën e vitit 2009, përmes Studimit për Kosovën, KE edhe zyrtarisht njohu mundësinë e fillimit të një procesi të tillë me Qeverinë e Kosovës, dhe një qëndrim i tillë u pasqyrua edhe në takimin e Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA) për Drejtësi, Liri dhe Siguri, dhe në takimin plenar të DPSA-së të atij viti, kur si kushte kryesore për fillimin e një procesi të tillë u përmend sigurimi i ri-

---

<sup>86</sup> Ibid.

<sup>87</sup> Në vitin 2009 në pikat kufitare të Kosovës ishte instaluar sistemi amerikan për kontrollimin e kufijve PISCES (Personal Identification Secure Comparison and Evaluation System), i cili ishte vlerësuar si jo në përputhje me legjislacionin evropian për mbrojtjen e të dhënave personale. Në anën tjetër, Komisioni Evropian ishte në proces të implementimit të një projekti për asistencë Policisë Kufitare, me qëllim pajisjen e saj me sistemin evropian për kufijtë BMS (Border Management System), i cili më në fund është instaluar në shtator të këtij viti. Në anën tjetër me rekomandim dhe asistencë të BE-së në maj 2010 u miratua Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili është në përputhshmëri të plotë me legjislacionin e BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale, që në momentin e miratimit po e bënte sistemin PISCES të jashtë-ligjshëm. Për më shumë shihni *Sundimi i Ligjit në Kosovën e Pavarur*, Grupi Ndërkombëtar i Krizave, maj 2010, fq. 2, [http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/balkans/kosovo/204%20The%20rule%20of%20Law%20in%20Independent%20Kosovo.pdf](http://www.crisisgroup.org/~/media/Files/europe/balkans/kosovo/204%20The%20rule%20of%20Law%20in%20Independent%20Kosovo.pdf)

<sup>88</sup> Shihni *Ligjin për Policinë*, [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L035\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L035_al.pdf); *Plani Zhvillimor Strategjik i Policisë së Kosovës 2008-2010*, [http://www.kosovopolice.com/repository/docs/PLANI\\_STRATEGJIK.pdf](http://www.kosovopolice.com/repository/docs/PLANI_STRATEGJIK.pdf), dhe *Plani Zhvillimor Strategjik i Policisë së Kosovës 2010-2015*, Policia e Kosovës, Prishtinë

<sup>89</sup> *Raporti Programatik i EULEX-it 2011*, fq. 18, <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/tracking/EULEX%20ProgrammeReport%202011.pdf>

<sup>90</sup> *Raportet e Progresit të KE-së për Kosovën: 2008, 2009, 2010* japin të njëjtin vlerësim (seksioni për Policinë në kuadër të fushës së Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë).

<sup>91</sup> Për dallim nga vendet e rajonit të cilat kanë pranuar udhërrëfyese zyrtarë nga KE në fillim të dialogut për liberalizim të vizave, Kosova në mënyrë unilaterale ka miratuar një udhërrëfyese të tillë, i cili ishte hartuar duke u bazuar në udhërrëfyese të vendeve fqinje. Për më shumë shihni Plani i Veprimit për Implementimin e Udhërrëfyesisë të Qeverisë së Kosovës për Liberalizimin e Vizave me BE-në 2009-2011, [http://www.mpb-ks.org/repository/docs/VisaLiberalizationActionPlan\\_ALB.pdf](http://www.mpb-ks.org/repository/docs/VisaLiberalizationActionPlan_ALB.pdf)



integritet të qëndrueshëm të shtetasve të riatdhesuar, duke filluar nga miratimi i Ligjit për Riatdhesim.<sup>92</sup> Me qëllim të adresimit të këtyre kushteve, është miratuar ky ligj dhe janë negociuar e nënshkruar marrëveshje bilaterale për ri-pranim me një numër të konsiderueshëm shtetesh anëtare të BE-së. Gjithashtu është miratuar një Strategji për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe është themeluar fondi i veçantë i Qeverisë për ri-integrim, në mbështetje të implementimit të kësaj strategjie.

Për më tepër, niveli qendror u angazhua edhe me komunat për të siguruar ri-integrimin e personave të riatdhesuar.<sup>93</sup> BE-së i janë dashur tri misione ekspertësh të dërguar në Kosovë për të vlerësuar situatën rreth ri-integrimit të personave të riatdhesuar, për të vendosur më në fund vetëm këtë vit që të lansojë dialogun për vizat, i cili pritet të fillojë kah fundi i këtij viti.<sup>94</sup> Megjithëse, edhe nën presionin e lartë nga BE, Qeveria duket të ketë marrë procesin e liberalizimit të vizave me më shumë përkushtim, shfrytëzimi i këtij për pikë politike dhe përcaktimi i afateve jo-serioze, sidomos nga niveli më i lartë politik i vendit, kanë bërë që procesi herë-herë të marrë përmasa kundërthënëse, duke treguar kështu edhe kapacitetin e kufizuar të Qeverisë për komunikim adekuat me BE-në dhe Shtetet Anëtare.

Në përgjithësi, vetëm aty nga fundi i periudhës që mbulon Programi Qeveritar 2008-2011 u vërejt një angazhim më i lartë për sa i përket reformimit të sistemit gjyqësor në Kosovë dhe fushës së punëve të brendshme. Edhe pse duket të ketë pasur një numër angazhimesh, sidomos për sa i përket plotësimit të kornizës ligjore dhe asaj strategjike, prapë se prapë në të dy fushat Kosova ende mbetet mbrapa në zhvillimin e institucioneve profesionale dhe të pavarura. Kërkohen shumë më tepër përpjekje dhe zhvillim konsensusi nacional për të mbështetur procesin e fuqizimit të këtyre sektorëve, që shpesh bien pre e politikës së çastit.

---

<sup>92</sup> Shihni *Communication from the Commission to the European Parliament and Council – Kosovo Fulfilling its European Perspective*, [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2009/kosovo\\_study\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/kosovo_study_en.pdf); *Konkluzionet e Nën-komitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri të DPSA-së*, janar 2010, [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu\\_kosovo/100329\\_sapd\\_jls\\_subcommittee\\_final\\_conclusions\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/100329_sapd_jls_subcommittee_final_conclusions_en.pdf); dhe *Konkluzionet e Takimit Plenar të DPSA-së*, korrik 2010, [http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu\\_kosovo/plenary\\_of\\_the\\_stabilisation\\_association\\_process\\_dialogue\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/plenary_of_the_stabilisation_association_process_dialogue_en.pdf)

<sup>93</sup> *Raportet e Progresit të KE-së për Kosovën: 2010 dhe 2011*, seksioni për viza, menaxhim kufijsh, azil dhe migrim, në kuadër të fushës për Drejtësi, Liri dhe Siguri.

<sup>94</sup> *Strategjia e Zgjerimit të KE-së 2011-12*, fq. 21, [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2011/package/strategy\\_paper\\_2011\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/strategy_paper_2011_en.pdf)

### Transporti

#### Objektivat

Sa i përket transportit, Programi Qeveritar 2008-2011 i kishte ndarë objektivat e kësaj fushe në: a) infrastrukturën rrugore; b) hekurudhat dhe c) aviacionin civil.<sup>95</sup> Për sa i takon infrastrukturës, Programi synonte të orientonte investimet publike në ndërtimin e autostradave R6 dhe R7, ndërtimin e rrugëve të reja, zgjerimin dhe rehabilitimin e rrugëve, ri-kategorizimin e tyre si dhe rritjen e sigurisë në komunikacion. Për më tepër, për sa i takon përmirësimit të hekurudhave, Programi kishte si qëllim krijimin e legjislacionit të nevojshëm dhe organeve rregullatore për këtë fushë, investimet për përmirësime infrastrukturore dhe për zhvillimin e shërbimeve të transportit hekurudhor, si dhe shtimin e sigurisë në këtë fushë të transportit. Në anën tjetër, për sa i përket aviacionit civil, Programi kishte vënë si synim implementimin e legjislacionit relevant, investimet në modernizimin e Aeroportit të Prishtinës, aftësimin e aeroportit të Gjakovës dhe krijimin e njësisë së helikopterëve.<sup>96</sup>

Për dallim nga fushat tjera në kuadër të këtij Programi, në këtë fushë objektivat për t'u arritur gjatë mandatit qeveritar janë renditur në mënyrë më kualitative, mirëpo si edhe në fushat tjera, nuk janë bërë përpjekje për të zhvilluar indikatorë për matjen e arritjes së tyre.

#### Implementimi

Me fillimin e implementimit të këtij Programi, Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit (MTPT) iu nda buxhet prej rreth €111 milionë, një rritje kjo e konsiderueshme nga shuma prej rreth €35 milionë që i ishin ndarë në vitin paraprak.<sup>97</sup> Vetëm gjatë vitit të parë të implementimit të këtij programi, MTPT i doli të shpenzonte rreth 91% të kësaj shume, shumica dërmuese e së cilës në shpenzime kapitale. Buxheti i ndarë për këtë ministri në dy vitet e ardhshme do të arrijë shumë prej gjithsej rreth €350 milionë, duke kthyer kështu politikat e transportit, e sidomos prioritetet e infrastrukturës rrugore, në sektorin numër një të investimeve publike. Investimet kapitale në këtë fushë gjatë periudhës 2008-2010 janë zhvilluar në kuadër të ngritjes së përgjithshme të investimeve kapitale nga 4.6% e PBB-së në 2007 në 9-10% gjatë periudhës 2008-2010.<sup>98</sup>

Sa i përket *infrastrukturës rrugore*, si investime me më së shumti shpenzime të përfshira ishin segmenti i rrugës Prishtinë - Fushë-Kosovë, rreth-rrotullimi në Prishtinë, dhe rruga

---

<sup>95</sup> Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2008-2011, fq. 17, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi\\_Qeveritar\\_2008\\_-\\_2011.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_Qeveritar_2008_-_2011.pdf). Ky raport nuk do të merret me fushën e telekomunikacionit, e cila gjendet e grupuar me fushën e transportit në PQ 2008-11.

<sup>96</sup> Ibid, f 18-19.

<sup>97</sup> Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës 2007, fq. 2, [http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2006regs/RA2006\\_61\\_schedules.pdf](http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2006regs/RA2006_61_schedules.pdf); dhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2009 – 2011, fq. 48, <http://mef-rks.org/sg/download/318-korniza-afatmesme-e-shpenzimeve>

<sup>98</sup> Duhet përmendur se vetëm shpenzimet kapitale publike të vitit 2011 në lidhje me Autorrugën 7, kanë ngritur përqindjen e shpenzimeve kapitale në rreth 12% të GDP.



Prishtinë-Mitrovicë si dhe fillimi i ndërtimit të autostradës 7 (Vërmicë - Merdare).<sup>99</sup> Ajo se çfarë është vërejtur gjatë implementimit të këtyre projekteve janë vonesat e shumta dhe dështimi për të arritur kryerjen e punëve në afatet e marra vesh në mes Qeverisë dhe kontraktuesve.<sup>100</sup> Për më tepër, implementimi i projektit rrugor Vërmicë - Merdare (si projekti publik më i madh që nga lufta, me shpenzime të vlerësuara rreth €800 milionë), ka shënuar një nga ngjarjet më kundërthënëse, shtuar kësaj edhe mungesën e transparencës gjatë zhvillimit të projektit dhe mos-bërjen publike të kontratës së nënshkruar me kontraktuesin.<sup>101</sup> Për më tepër, implementimi i këtij projekti kishte shtyrë Qeverinë të planifikojë privatizimin sa më të shpejtë të Postës dhe Telekomit të Kosovës, në mënyrë që t'i mundësohej mbulimi i shpenzimeve të larta për buxhetin e vendit, mirëpo edhe të bënte shkurtime buxhetore nga fusha të tjera.<sup>102</sup> Edhe pse shtimi i buxhetit për infrastrukturën rrugore ka përmirësuar sadopak gjendjen në këtë fushë, mungesa e transparencës gjatë të gjitha fazave të realizimit të investimeve publike ka dëmtuar qëndrueshmërinë e nevojshme për zhvillimin e fushës. Qeveria duhet të bëjë përpjekje që përmes sigurimit të masave të transparencës të sigurojë impaktin adekuat që investimet publike duhet të kenë në zhvillimin e vendit.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është miratuar Ligji për Siguri Rrugore dhe ka filluar lëshimi i patentë-shoferëve të Republikës së Kosovës, kurse është themeluar edhe Njësi për Planifikim të Transportit në kuadër të MTPT-së, si dhe një Këshill për Siguri Rrugore. Gjatë kësaj kohe, Kosova ka vazhduar pjesëmarrjen në Traktatin e Komunitetit për Transport, përmes miratimit të një plani shumëvjeçar për siguri në rrugë si dhe nënshkrimit të një numri marrëveshjesh në fushën e transportit me vendet e rajonit.<sup>103</sup> Megjithatë, gjatë gjithë kësaj kohe funksionet e MTPT ishin më shumë të përqendruara në menaxhimin e përditshëm të projekteve infrastrukturore sesa në zhvillimin dhe monitorimin e politikave të transportit, shtuar kësaj edhe kapacitetet e kufizuara të Inspektoratit të Transportit.

Në anën tjetër, sa i përket hekurudhave, gjatë periudhës që mbulon ky raport, u miratua Ligji për Hekurudhat, i cili vuri bazën ligjore për themelimin e Autoritetit Rregullator të

---

<sup>99</sup> Nuk ka të dhëna të sakta se sa kilometra rrugë janë shtruar gjatë kohës që mbulon ky raport. Kështu, Raporti i Punës së Qeverisë 2009, indikon se për vitet 2008-9 janë shtruar rreth 1000 km rrugë rajonale dhe lokale (fq. 37), kurse KASH 2012 përmend vetëm numrin e projekteve rrugore, si dhe përmend se rreth 750 km rrugë lokale janë shtruar tri vitet e fundit (fq. 77).

<sup>100</sup> *Transparenca e Investimeve Publike në Infrastrukturën Rrugore*, qershor 2010, fq. 15,

[http://levizjafol.org/images/uploads/files/Transparenca\\_e\\_investimeve\\_publike\\_n%C3%AB\\_infrastruktur%C3%ABn\\_rrugor\\_e1112.pdf](http://levizjafol.org/images/uploads/files/Transparenca_e_investimeve_publike_n%C3%AB_infrastruktur%C3%ABn_rrugor_e1112.pdf)

<sup>101</sup> *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2012-2014*, fq. 150, <http://mef-rks.org/en/download/korniza-afatmesme-e-shpenzimeve/korniza-afatmesme-e-shpenzimeve-2012-2014/4033-korniza-afatmesme-e-shpenzimeve-2012-2014>. Për mungesën e transparencës rreth kontratës në mes MTPT dhe Bechtel&Enka, shih raportin e FOL, *Transparenca e Investimeve Publike në Infrastrukturën Rrugore*, qershor 2010,

[http://levizjafol.org/images/uploads/files/Transparenca\\_e\\_investimeve\\_publike\\_n%C3%AB\\_infrastruktur%C3%ABn\\_rrugor\\_e1112.pdf](http://levizjafol.org/images/uploads/files/Transparenca_e_investimeve_publike_n%C3%AB_infrastruktur%C3%ABn_rrugor_e1112.pdf)

<sup>102</sup> *Raporti i Progresit – Made in Kosova 2011*, fq. 43, [http://www.fes-](http://www.fes-prishtina.org/wb/media/Publications/2011/Made%20in%20Kosovo%202011%20(Shqip).pdf)

[prishtina.org/wb/media/Publications/2011/Made%20in%20Kosovo%202011%20\(Shqip\).pdf](http://www.fes-prishtina.org/wb/media/Publications/2011/Made%20in%20Kosovo%202011%20(Shqip).pdf)

<sup>103</sup> *Raportet e Progresit për Kosovën nga KE, 2009 dhe 2010*, fusha e Politikave Sektoriale, seksioni për Politikat e Transportit.

Hekurudhave që u themelua në vitin 2010.<sup>104</sup> Ndarja e menaxhimit të infrastrukturës dhe operimit të trenave, e paraparë me ligj, ende nuk është bërë funksionale edhe pse në vitin 2011 (katër vite pas miratimit të ligjit) Infrakos dhe Trainkos u regjistruan si kompani publike për këtë qëllim.<sup>105</sup> Gjatë periudhës në fjalë, u arrit marrëveshje e kalimit të kufirit me Maqedoninë, dhe eksportet nga Ferronikeli përmes transportit hekurudhor duket të kenë ndikuar në përmirësimin e shfrytëzimit të këtij lloji të transportit.<sup>106</sup> Megjithatë, transporti hekurudhor nuk duket të jetë lart në prioritetet e Qeverisë, ndër të tjera për shkak të buxhetit të kufizuar për këtë fushë (sidomos në krahasim me buxhetin për transportin rrugor), si dhe ngadalësinë në kompletimit të kornizës ligjore dhe asaj institucionale në këtë fushë.

Për më tepër, sa u përket zhvillimeve në *fushën e aviacionit civil*, gjatë periudhës që mbulon ky raport, në vitin 2008 është miratuar Ligji për Aviacionin Civil, me qëllim të zëvendësimit të legjislacionit të UNMIK-ut për këtë fushë. Po atë vit është emëruar Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil, autoritet ky që mori përsipër të gjitha përgjegjësitë në fushën e aviacionit civil, vetëm në fillim të vitit 2009.<sup>107</sup> Gjatë gjithë kësaj periudhe Kosova ka marrë pjesë në aktivitetet e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA), duke siguruar transpozimin e legjislacionit përkatës të BE-së (*Acquis*) për fazën e parë të implementimit të legjislacionit të paraparë në Marrëveshjen për Hapësirën së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA), por edhe një pjesë të legjislacionit të fazës së dytë.<sup>108</sup> Në vitin 2009, Qeveria filloi procedurat për koncensionimin e Aeroportit të Prishtinës, dhe pas zhvillimit të procedurave të tenderimit, marrëveshja për koncesion u nënshkrua me konsorciumin turko-francez *Limak - Airport de Lyon MAS*, i cili do të menaxhojë Aeroportin e Prishtinës për 20 vitet e ardhshme dhe do të investojë rreth €100 milionë në modernizimin e tij.<sup>109</sup>

Me gjithë progresin e arritur, sfidë në këtë fushë mbetet ngritja e kapaciteteve të institucioneve relevante të menaxhimit të aviacionit civil, mirëpo edhe në implementimin e legjislacionit vendës që tanimë është në harmoni me *Acquis*-në përkatëse. Gjithashtu, zhvillimi i këtij sektori po has vështirësi për shkak të pengesave të Serbisë për fluturim mbi territorin e saj.

---

<sup>104</sup> Konkluzionet e Nën-komitetit për Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal, maj 2010, fq. 2,

[http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu\\_kosovo/sectoral\\_meeting\\_on\\_transport\\_environment\\_energy\\_and\\_regional\\_development\\_10\\_11\\_may\\_2010\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/sectoral_meeting_on_transport_environment_energy_and_regional_development_10_11_may_2010_en.pdf)

<sup>105</sup> Konkluzionet e Nënkomitetit për Mjedis, Transport, Energji dhe Zhvillim Rajonal, mars 2011, fq. 8,

[http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu\\_kosovo/11032425\\_sapd\\_sectoral\\_meeting\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/11032425_sapd_sectoral_meeting_en.pdf)

<sup>106</sup> Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën 2010, fq. 44,

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2010/package/ks\\_rapport\\_2010\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf)

<sup>107</sup> Raporti i Punës së Qeverisë, 2008, fq. 146-147, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RAPORTI\\_VJETOR\\_I\\_PUNES\\_SE\\_QEVERISE\\_2008.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RAPORTI_VJETOR_I_PUNES_SE_QEVERISE_2008.pdf)

<sup>108</sup> Raporti i Progresit i KE-së për Kosovën 2010, fq. 45,

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2010/package/ks\\_rapport\\_2010\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/ks_rapport_2010_en.pdf)

<sup>109</sup> [http://www.eciks.org/english/lajme.php?action=total\\_news&main\\_id=1022](http://www.eciks.org/english/lajme.php?action=total_news&main_id=1022)

### Konkluzione dhe rekomandime

Partitë politike në një vend me demokraci të konsoliduar fitojnë apo humbasin zgjedhje bazuar në programet e tyre, që zakonisht kanë vizion dhe objektiva të qarta, janë të matshëm dhe lehtësisht të kuptueshëm për qytetarin. Programi i Qeverisë së Kosovës, implementimin e të cilit jemi përpjekur ta shtjellojmë në këtë raport nuk ka asnjërin nga këto kualitete. I zhvilluar shumë kohë pas formimit të Qeverisë, këtij programi i mungon koherenca në paraqitjen e objektivave për t'u arritur përmes implementimit të tij, dhe ai ka qenë vështirë i matshëm. Për më tepër, duke pasur parasysh mungesën e njëtrajtshmërisë në definimin e objektivave në të gjithë sektorët që mbulon, Programi demonstroi problemet thelbësore me të cilat përballen partitë politike kosovare në fushën e harmonizimit të politikave.

Siç u përmend edhe më sipër, ky raport ka si qëllim zhvillimin e një qasjeje vlerësuese të implementimit të politikave qeveritare, dhe si hap të parë në këtë drejtim kemi përzgjedhur një numër sektorësh të cilët janë me interes për misionin dhe fushëveprimin e Lëvizjes FOL, duke shpresuar kështu se do të përcillemi nga pjesa tjetër e shoqërisë civile kosovare në zhvillimin e raporteve vlerësuese mbi shkallën e implementimit të këtij dhe programeve të ardhshëm të Qeverisë, por edhe të pjesës tjetër të politikave dhe strategjive të institucioneve publike të të dyja niveleve. Kjo besojmë se do të ndihmonte në përmbushjen e përgjegjësisë që kemi si shoqëri civile por edhe në përmirësimin e politikave qeveritare, përfshirë implementimin e tyre.

Kështu, seksioni për arsimin i këtij raporti përmbledh disa prej aktiviteteve kryesore në fushën e arsimit të zhvilluara gjatë periudhës kohore 2008 - 2010, përfshirë përmirësimin e infrastrukturës fizike, si dhe përpjekjet për zhvillimin e kornizës ligjore dhe strategjike për arsim. Ky sektor, megjithatë, përballet me një numër sfidash strukturore të cilat kërkojnë shumë më tepër përpjekje të institucioneve përkatëse qeveritare.

Më tej, sa i përket zhvillimit të politikës së jashtme, Kosova mbetet në fillimet e zhvillimit të kapaciteteve të saj, si për shkak të ambientit jo fort të përshtatshëm ndërkombëtar (numri i shteteve që nuk njohin Republikën e Kosovës dhe implikimet e kësaj për anëtarësimin në OKB), ashtu edhe për shkak të përpjekjeve të pamjaftueshme të Qeverisë për të zhvilluar këtë fushë.

Reforma e administratës publike është një nga ato fusha ku është shënuar më së paku progres për shkak të mungesës së vullnetit politik, por edhe për shkak të orientimit të gabuar të politikave në kuadër të kësaj reforme (fokusi në e-qeverisje në një kohë kur as legjislacioni themelor për shërbimin civil nuk ishte kompletuar). Qeverisë i duhet një qasje shumë më sistematike dhe ofrim resursesh shumë më të avancuara për progres në këtë fushë.

Në anën tjetër, sa i përket sundimit të ligjit, do të ishte shumë e vështirë të vihej në përfundim se kjo fushë ishte prioritet i Qeverisë bazuar në këtë Program. Kjo është fusha ku është arritur shumë pak progres sa i përket rezultateve, edhe pse korniza ligjore dhe ajo e politikave duket të jetë plotësuar në mënyrë të kënaqshme. Megjithatë, duhet qasje shumë më serioze nga ana e Qeverisë, sidomos për sa i përket përbërjes së këtyre

politikave dhe zhvillimit të mekanizmave mbikëqyrës në fushat me rrezik më të lartë për korrupsion, si dhe në përmirësimin e bashkëpunimit me gjyqësorin për luftimin e suksesshëm të dy fenomeneve më negative në këtë fushë: krrimit të organizuar dhe korrupsionit.

Fusha e transportit është fusha së cilës i është shumëfishuar buxheti gjatë kohës që mbulon ky raport, por gjithashtu edhe fusha në të cilën në mënyrë proporcionale janë shumëfishuar çështjet kontroverze. Kjo është fusha ku duhet të rritet dukshëm transparenca nga ana e Qeverisë, sidomos për sa i përket planifikimit të investimeve publike, por edhe implementimit të tyre.

### **Rekomandime të përgjithshme:**

- Partitë politike kosovare duhet që me urgjencë të rrisin kapacitetet e veta për planifikim politikash, monitorim dhe vlerësim. Kjo duhet të bëhet në kuadër të përpjekjeve për të zhvilluar politika vizionare koherente, të cilat ndër të tjera, duhet të jenë të matshme dhe lehtësisht të komunikueshme.
- Qeveria duhet që me urgjencë të zhvillojë kapacitetet e saj për planifikim strategjik koherent dhe të koordinuar, përfshirë këtu edhe kapacitetin e nivelit politik për politikë-bërje koherente dhe të integruar.
- Qeveria duhet të rrisë përpjekjet për zhvillimin e kapaciteteve monitoruese të implementimit të politikave dhe strategjive qeveritare, dhe të sigurojë qasje të lehtë në raportet monitoruese për të gjithë, sidomos në rrjet.
- Qeveria duhet të fillojë me shfrytëzimin e qasjes që siguron vlerësim objektiv të implementimit të politikave qeveritare. Në një mjedis ku një qasje e tillë është e kushtueshme, bashkëpunimi me shoqërinë civile është me rëndësi kyçe.

### **Rekomandimet për sektorët e veçantë që mbulon raporti:**

#### **Arsimi**

- Qeveria duhet të fokusohet në zhvillimin e politikave dhe kapaciteteve institucionale që do të siguronin ri-fokusimin e prioriteteve dhe resurseve financiare nga nevojat themelore të përmirësimit të infrastrukturës fizike në drejtim të përmirësimit të cilësisë në të gjitha nivelet, fushat dhe aspektet e politikave të arsimit dhe kërkimeve shkencore, duke adresuar me prioritet zhvillimin dhe implementimin e politikave për trajnimin e vazhdueshëm të mësimdhënësve, ngritjen e kapaciteteve dhe resurseve të institucioneve publike të arsimit në kërkime shkencore, avancimin e dukshëm të bashkëpunimit me institucione partnere të vendeve të tjera, dhe shfrytëzimin më të mirë të programeve përkatëse të BE-së dhe atyre ndërkombëtare.
- Qeveria duhet të sigurojë intensifikimin e përpjekjeve dhe përqendrimin e resurseve në ngritjen e kapaciteteve institucionale, në veçanti të Ministrisë së Arsimit, por edhe të Komunave, në zhvillimin, si dhe implementimin e monitorimin e politikave, për të mundësuar implementimin adekuat dhe me kohë të kornizës strategjike në fuqi, në veçanti të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011 - 2016, Strategjisë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007 - 2017, Strategjisë për Zhvillimin e Arsimit të Lartë në Kosovë 2005 - 2015, dhe Kornizës së Kurrikulit të Kosovës.

- Institucionet qeverisëse në të dyja nivelet duhet të intensifikojnë përpjekjet dhe të mobilizojnë resurset për të përmirësuar dukshëm gjithëpërfshirjen në sistemin e arsimit publik në të gjitha nivelet, përfshirë duke i dhënë prioritet kompletimit të kurrikulumit dhe mjeteve mësimore në gjuhët e minoriteteve, parandalimit dhe adresimit të braktisjes së shkollës dhe përfshirjes më të mirë të fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor.
- Institucionet përkatëse qeverisëse në të dyja nivelet duhet të intensifikojnë përpjekjet dhe të alokojnë resurset adekuate për të përmirësuar ndërlidhjen në mes të sistemit arsimor dhe tregut të punës, përfshirë përmes zhvillimit të politikave dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale për arsimim dhe trajnime profesionale, por gjithashtu përmes lehtësimit të vendosjes së partneritetit në mes të institucioneve arsimore dhe punëdhënësve (si të sektorit publik ashtu edhe të atij privat).

### ***Politika e jashtme***

- Forcimi i mëtejshëm i MPJ, dhe misionëve diplomatike, përmes rekrutimit të bazuar në merita, trajnimit adekuat të stafit dhe ofrimit të resurseve të duhura.
- Sigurimi i koordinimit në mes të MPJ dhe akterëve tjerë qeveritarë me përgjegjësi në fushën e politikës së jashtme.
- Sigurimi i një politike të qartë për bashkëpunim rajonal dhe për mënyrën e përfaqësimit të Kosovës në iniciativat rajonale.

### ***Reforma e administratës publike***

- Sigurimi i një kornize adekuate strategjike me përkrahje politike, për zhvillimin e RAP, përfshirë fuqizimin e institucioneve që menaxhojnë këtë proces.
- Implementimi i përshtetshëm i legjislacionit bazik për shërbimin civil.
- Implementimi i rezultateve të rishikimit funksional, dhe përmirësimi i monitorimit në këtë fushë.
- Fokusimi në zhvillimin e menaxhimit të resurseve humane në të gjithë administratën publike.

### ***Sundimi i ligjit***

- Përkrahja e fuqizimit të mekanizmave për menaxhimin e gjyqësorit, duke siguruar pavarësinë e tyre.
- Mbështetja e reduktimit të barrës së punës për gjykatat përmes funksionalizimit të mekanizmave të ndërmjetësimit dhe noterisë.
- Mbështetja e procesit të ri-strukturimit të gjykatave dhe prokurorive, bazuar në legjislacionin e ri në fuqi.
- Kompletimi i kornizës ligjore dhe strategjike për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.
- Zhvillimi i kapaciteteve për mbrojtjen e dëshmitarëve.

- Ngritja e kapaciteteve për hetimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.
- Zhvillimi i një qasjeje sektoriale (sidomos për sektorët me rrezik më të lartë të korrupsionit si: menaxhimi i taksave, doganat, policia, prokurimi publik, arsimi, shëndetësia, etj) për parandalimin e korrupsionit.
- Zhvillimi i kapaciteteve për konfiskimin e pasurisë së së përvetësuar në mënyrë të paligjshme dhe kapaciteteve për menaxhimin e kësaj pasurie.

### *Transporti*

- Përmirësimi në planifikimin e investimeve publike, duke siguruar transparencë gjatë gjithë fazave të realizimit të tyre.
- Rritja e shkallës së fokusimit të resurseve qeveritare në drejtim të zhvillimit të fushës së transportit hekurudhor dhe të aviacionit civil.
- Qeveria duhet të sigurojë ngritjen e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e të tri llojeve të transportit.

## Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të hapur. Ky raport është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i Lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë ueb faqe: [www.levizjafol.org](http://www.levizjafol.org)

## Rreth Lëvizjes FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

### **Kontakto:**

Andrea Gropa 35, 100000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Mob: +377 (0) 44 131 542  
Ueb: [levizjafol.org](http://levizjafol.org)  
E-mail: [info@levizjafol.org](mailto:info@levizjafol.org)